

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.**



RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2018



Mars 2019

1. PËRMBAJTJA

1. Përmbajtja	2
Hyrje.....	3
2. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.....	4
• Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	4
o Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2018	4
o Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe Plan të Biznesit.....	9
o Një pasqyre e të priturve për vitin 2019.	12
• Informacione lidhur me kapitalin dhe devidenten.....	12
o Kreditë e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë vitit.....	12
o Plani i Investimet e bëra gjatë vitit 2018	12
o Dividendët e paguara gjatë vitit 2018	13
• Të dhëna për Drejtorët jo-ekzekutiv	13
o Bordi i Drejtorëve në KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë ka këtë përbërje	13
o Kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2018.....	13
o Numri dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e rregullta të BtD, gjatë vitit 2018.	13
o Komisioni i Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë ka këtë përbërje:.....	15
• Informacione te tjera	16
o Kërkesat për likuidimin e Ndërmarrjeve shoqërore për vitin 2018	16
o Informacione tjera, ashtu siç parashihet në LNP dhe statutin e NP-ve.....	16
3. Raporti i Zyrarit Kryesor Ekzekutiv.....	17
• Ngjarjet kryesore të vitit 2018	17
• Pasqyrën e performances operative dhe financiare si dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances.....	21
o Prodhimi i ujit.....	21
o Kualiteti i ujit	22
o Çështjet Ligjore.....	22
• Pasqyra e performances financiare dhe rezultatet	23
• Progresi me planin e Biznesit	23
• Perspektiva për vitin e ardhshëm	25
• Rreziqet e të ardhmes së korporatës.....	26

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës, është pronare e shoqërive aksionare me kapital publik. Kompania e Ujësjiellësit Rajonal "Hidrodrini" SH. A., themelohet në zbatim të Ligjit Nr. 03/L- 087, "Mbi Ndërmarrjet Publike" dhe Ligjit Nr. 02/L-123, "Për Shoqëritë Tregtare", të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74, të datës 14.07.2009 dhe të Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1, të datës 30.09.2009. Shoqëria është trashëgimtare e Ndërmarrjes Publike, Kompania e Ujësjiellësit Rajonal "Hidrodrini" Holding SH. A

Numri popullatës që Kompania Rajonale, "HIDRODRINI" iu kryen shërbime me ujë të pijes vlerësohet rreth 185.000 banor, gjegjësisht me 996 Km gjatesi të rrjetit të ujesjellesit ndërsa shërbimet e ujërave të zeza ~ 60,000 banor, gjegjësidht me 132.5 Km gjatsi të rrjetit të ujerave të zeza. Kapaciteti momental prodhues sillet 25.336.310 m³/Vjet.

Kompania është dhe do të mbetet ofrues profesional i furnizimit me ujë të pijshëm të kualitetit të lart dhe të shërbimeve të kanalizimit. Prodhimi, shitja e ujit, shërbimet e kanalizimit dhe shërbimet tjera janë detyrat kryesore të kompanisë.

Qendra e kompanisë është në Pejë, në strukturën e vetë ka 5 njësi të biznesit në Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan.

Bordi i Drejtoreve i përzgjedhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është organ i pavarur dhe bënë drejtimin dhe mbikëqyrjen e biznesit të kompanisë. Stafi menaxhues i kompanisë organizon punën, kryen udhëheqjen efektive të veprimtarisë dhe stafit.

Raporti Vjetor I KRU " Hidrodrini" Sh. A. - Pejë për vitin 2018 është përpiluar duke u bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dispozitën 28.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporatave të Ndërmarrjeve Publike dhe Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjeve Publike të lëshuar nga Njësia për Politikë dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike .

2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të NP-së ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarin e zyrtarëve të NP-së, gjithnjë në përputhje me te drejtat dhe përgjegjësit e Bordit.

- **Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes**

- ***Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2018***

- Përkushtim, angazhim më i madhë i punëtorëve në teren.
- Matje korrekte të konsumit.
- Riparim të rrjedhjeve sipërfaqësore.
- Reduktim të sasisë së ujit në zona të caktuara (presioni).
- Identifikim të shfrytëzuesve të pa autorizuar (vjedhja e ujit).
- Rritje e numrit të konsumatorëve.
- Rritjen e investimeve në zëvendësim e gypave të vjetër.
- Rritja e shkallës së arkëtimit.
- Hartimi i listës me emra të borxhlive dhe procedimi me Përmbarues.
- Vazhdimi i kontratave me PTK, për pagesat e faturave në pikat e tyre.
- Ngritja e efikasitetit të stafit.
- Sistemitimi i punëtorëve dhe organogrami i ri, me mbështetje konsulencia.
- Përforcimi i zbatimit të Ligjit.

Gjatë kësaj periudhe Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit në mbledhjet e rregullta të mbajtura gjatë vitit 2018 kanë marrë vendime dhe kanë dhënë rekomandime apo sygjerime për zgjidhjen çështjeve të ndryshme të cilat kanë pasur ndikim pozitiv në performancën e Kompanisë, si për :

- Rritjen e arkëtimit të borxheve;
- Zvogëlimin e humbjeve të ujit;
- Zvogëlimin e shpenzimeve;
- Furnizimin me ujë të konsumatorëve 24 h/në ditë;
- Kualitetin dhe sasinë e ujit të prodhuar;
- Harmonizimin e Planit të Biznesit të KRU "Hidrodrini" Sh. A. me planet komunale
- Ndërmarrjen e aktiviteteve për rritjen e faturimit si dhe
- Reduktimin e lidhjeve të pa autorizuara.

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2018 ka përcjell edhe ecurin e implementimit të Projekteve :

- Investimet nga Banka Gjermane, Zyra Zvicerane dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për Ndërtimin e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza
Bordi i Drejtorëve është njoftuar me punën e dy Konsulencave AMC Sachsen Wasser (Leipzig) dhe IC Dahlem Ber.(Essen) duke filluar nga hartimi i Raporteve fillestare, Takimet e ndryshme të mbajtura si dhe për Marrëveshjet e nënshkruara.
- Investimet nga Zyra Zvicerane në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës
(Rehabilitimi i ujësjellësave rural dhe pas përfundimit të projekteve, integrimi i tyre në kuadër të KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë - Projekti i Jabllanicës, Raushiqit, disa fshatrave të Klinës, fshatrave të Deçanit)
- Projektin e financuar nga Banka Gjermane faza V në vlerë prej 8 mil. € për Pejë, Gjakovë dhe Prizren (rehabilitimi i kanaleve të ujërave të zeza dhe inqizimi i rrjetit)
- Projekti i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (Rehabilitimi i ujësjellësit të fshatit Strellc 360.000,00 €
- Riparimet e stacioneve të klorinimit,

Në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë, ndër të tjera janë shqyrtuar dhe janë aprovuar edhe këto dokumente :

- Plani i Menaxhimit të Thatësisë në KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë
(Vendimi Nr.prot.03/04/01/2018 dt.31.01.2018)
- Raporti Vjetor të Performancës të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2017
(Vendimi Nr. Prot.6/03/02/2018 dt.14.03.2018)
- Pasqyrat Financiare të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2017
(Vendimi Nr.prot.6/02/02/2018 14.03.2018)
- Raporti Vjetor mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2017 (Vendimi Nr.prot.9/02/03/2018 dt.30.03.2018).
- Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë për vitin 2017 (Vendimi Nr.prot.12/04/04/2018 dt.27.04.2018)

- Letër Menaxhmenti i Auditorit të Jashtëm pas auditimit të Pasqyrave Financiare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2017.(Vendimi nr.prot.15/02/05/2018 dt.29.05.2018)
- Plani i Veprimit lidhur me të gjeturat e Auditorit të Jashtëm për vitin 2017, I hartuar nga Menaxhmenti (Vendimi nr.prot.20/02/06/2018 dt.04.07.2018)
- Rishikimi i Planit të Biznesit 2018 (Vendimi Nr.prot.23/04/07/2018 dt.31.07.2018)
- Planin e Biznesit dhe Buxhetin Vjetor 2019-2021 (Vendimi Nr.prot.34/01/2018 dt.30.10.2018)
- Raportet Operative dhe Financiare mujore dhe TM ;
- Raportet mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës për TM ;
- Raportet mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve për TM ;
- Vlerësimi i performances së KRU “ Hidrodrini” Sh. A. (Vendimi Nr.prot.721 dt.30.05.2018)
- Vetëvlerësimi i Bordit të Drejtorëve (Vendimi Nr.prot.720 dt.30.05.2018)
- Deklarata për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të Lartë të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2017.(Vendimi Nr.prot.23/05/07/2018 dt.31.07.2018)
- Vendimin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë. Nr.prot.15/04/ 05/2018 Dt. 29.05.2018
- Rregulloren për llogaritjen e pagave të inkasantëve të KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë (Vendimi Nr.prot.29/02/09/2018 dt.02.10.2018)
- Aplikacioni I KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për përtrirjen e Licencës për kryerjen e shërbimeve nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit .Kryeshefi Ekzekutiv z.Agron Tigani autorizohet, në emër të KRU “ Hidrodrini” Sh. A.- Pejë të aplikoj për licencë të shërbimeve pranë Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit, (Vendimi nr.prot.15/03/05/2018 dt.29.05.2018).

Aktivitetet e Auditimit të Brendshëm

Raporti Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018 ,është përgatitur sipas detyrimeve që dalin nga Ligji mbi Ndërmarjet Publike.

Zyra e Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidrodrini" Sh.A gjatë vitit 2018 ka kryer Aktivitetet e Auditimit, sipas Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2018 , të aprovuar nga Komisioni i Auditimit. Plani vjetor është përgatitur sipas Planit Strategjik të aktiviteteve të auditimit të Brendshëm për periudhën kohore 2017-2019.

Gjatë vitit 2018 janë kryer auditimet sipas planit vjetor, nuk ka pasur auditime shtesë apo auditime me kërkesë nga Komisioni i Auditimit.

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2018, ka aprovuar Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2018 në mbledhjet e rregullta të Komisionit të Auditimit./

Tabela I :Aktivitetet e Auditimit të Brendshëm

Nr	Përshkrimi i Auditimit	Objektivat e Auditimit	Indeksi i rrezikut	Rekomandimet e dala nga auditimet	Person eli i angaz huar në auditim
1.	Mbikqyrja e punës së komisioneve regjistruese për stoqet inventarin asetet dhe paranë e gatshme.	Përcjellja e punës së komisioneve regjistruese .	2.00	1 rekomandim, i cili ka gjetur zbatim gjatë vitit.	1
2.	Auditimi i Njësisë Operative Istog.	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punës në këtë njësi operative.	3.00	3 rekomandime, prej të cilave dy rekomandime kanë gjetur zbatim gjatë vitit.	1

3.	Auditimi i Njësive Operative Deçan, Klinë Junik.	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punëve në këto njësi operative.	3.00	2 rekomandime , prej të cilave një rekomandim ka gjetur zbatim gjatë vitit.	1
4.	Shërbimi Juridik	Zbatimi i rregulloreve dhe procedurave për lëndët në procedurë permbarimore.	2.00	2 rekomandime, të cilat kanë nisur te gjejne zbatim gjatë vitit.	1
5.	Auditimi në Shërbimin Teknik (zyra e Gis-it.)	Funksionimi dhe mbarëvajtja e punës në këtë zyrë – njësi.	2.00	2 rekomandime ,të cilat pjesërisht janë zbatuar.	1
6.	Departamenti Financiar.Auditimi i menaxhimit të stoqeve.	Funksionimi dhe mbarëvajtja e depove, menaxhimi i stoqeve në të gjitha njësitë operative.	2.00	2 rekomandime, prej të cilave një ka filluar të zbatohet.	1
7.	Administrata (procedurat e punësimeve.)	Respektimi i Ligjeve dhe rregulloreve përkatëse mbi procedurat e	2.00	2 rekomandime, të cilat priten të zbatohen në vazhdimësi.	1

		punësimeve në Sektorin Publik.			
8.	Plani Vjetor për vitin 2019.	Përgatitja e planit vjetor për vitin 2019	1.00		1
9.	Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve gjatë vitit 2018.	Përcjellja dhe monitorimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dala gjatë vitit 2018.	3.00		1

Aktivitetet e Auditimit gjatë vitit 2018 janë realizuar sipas afateve kohore të parapara në Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm.

o Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitet paraprake dhe Plan të Biznesit


Vitet	2015	2016	2017	2018	Planifikuar 2018
Prodhimi (m ³)	25,559,988	25,563,723	25,659,957	25,336,310	24,600,000
Faturimi (m ³)	8.774.145	9.006.961	9.266.841	10.031.334	10.117.500
Humbjet (%)	66%	65%	62%	60%	59%
Shpenzimet (Euro)	2,191,685	2,285,876	2,448,283	2,501,846	2,644,512

Vitet	2015	2016	2017	2018	Planifikuar 2018
Faturimi (€)	3,443,182	3,537,082	3,644,856	3.754.879	3.935.394
Inkasimet (€)	2,507,335	2,764,127	2,912,768	3.224.363	3,190,638
Shkalle në %	73%	78%	80%	86%	81%
Norma e mbulesës së punës	1.16	1.23	1.21	1.30	1.22


Gjatë vitit 2018, inkasimi/arkëtimi është realizuar 101%, pra, me shumë se planifikimi, apo ne vlerë monetare me shumë për **33,725 euro**.

(Kemi një rritje konstante dhe stabile të inkasimit)

Faturimi:



Arketimi



Norma e mbulesës së punës gjatë viteve 2015 - 2018:

2015.....(1.16),

2016.....(1.23),

2017.....(1.21),

2018.....(1.30).

Në Gjitha vitet është siguruar qëndrueshmëria.

(Ky është raporti në mes hyrave dhe shpenzimeve).

Humbjet ujit gjatë viteve:

Viti 2015.....66%,

Viti 2016.....65%,

Viti 2017.....62%,

Viti 2018.....60%.

o ***Një pasqyre e të priturve për vitin 2018.***

Gjatë vitit 2018, është planifikuar që shkalla e Arkëtimit të jetë si në tabelën e më poshtme.

Aktiviteti	Viti 2018	Planifikuar Viti 2018
Faturimi (€)	3.754.879	3.935.394
Inkasimet (€)	3.224.363	3,190,638
Shkalle në %	86%	81%
Norma mbulesës së punës	1.30	1.22
Uji i Pa faturuar %	60%	59%

• **Informacione lidhur me kapitalin dhe devidenten**

o ***Kreditë e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë vitit***

Gjatë vitit 2018 nuk kemi pasur dhe as nuk kemi iniciuar ndonjë marrëveshje me institucionet financiare për huazim ose tërheqje të kredisë.

o ***Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2018***

1. Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit në fshatrat të cilat nuk janë në ombrellën e Hidrodrinit. Kemi Lugun e Baranit, si projekt i ri i cili ka 16 fshatra. Projekti nuk ka përfunduar ashtu që do të vazhdojë edhe në vitin 2019. (faza e parë si donacion nga Zyra Zvicerane dhe Qerveria e Kosovës, rrjeti shperndares, faza e dyte, kyqja në burim ku Hidrodrini dhe KK-Pejë do të investohet me bashkëfinancim).
2. Projekti i rehabilitimit të fshatrave të cilat kanë furnizim, por nuk janë nën ombrellën e Hidrodrinit siç janë: Jabllanica e Vogël, Raushiqi, rajoni i Vokshit, Doberdol, Glarev, Zabergj, Rigjevë, Mojstir, Sine projekti është në vazhdimësi edhe gjatë vitit 2019.
3. Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit në fshatin Strelc ka filluar gjatë vitit 2018, i cili do të jete në vazhdimësi edhe në vitin 2019.

o **Dividendët e paguara gjatë vitit 2018**

Meqenëse Kompania e Hidrodrinit për vitin 2017, ka një fitim prej 26,964 €, nga aksionari nuk është kërkuar që dividenda të paguhet.

• **Të dhëna për Drejtorët jo-ekzekutiv**

o **Bordi I Drejtorëve në KRU " Hidrodrini " Sh. A. Pejë ka këtë përbërje**

1. z. Burim Basha -ing. i dipl.i makinerisë, kryetar-dt. emërimit 24.10.2015
2. z Musë Mushkolaj-ing. i dipl.i bujqësisë, anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
3. z Esad Abdullahi- IDA, anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
4. z Skënder Veseli-ing. i makinerisë, anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
5. z Rasim Mahmutoviq-ing. i dipl. i elektrotek, anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
6. z Sokol Boqolli-ecc. i dipl,anëtar-dt. emërimit 24.10.2015
7. z.Agron Tigani-ing.i dipl. i ndërt. (hidroteknik), Kryeshef Ekzekutiv

o **Kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e Ndërmarrjes për vitin 2018**

z Burim Basha	- kryesues7,350.60 €
z Musë Mushkolaj	- anëtar5,696.08 €
z Esad Abdullahi	- anëtar4,997.84 €
z Skënder Veseli	- anëtar5,835.28 €
z Rasim Mahmutoviq	- anëtar4,804.25 €
z Sokol Boqolli	- anëtar5,920.68 €

o **Numri dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e rregullta të BtD, gjatë vitit 2018.**

KRU " Hidrodrini" Sh. A. Pejë				
Nr.rendor	Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve	Data	Ora	Personat prezent në mbledhje
1	E rregullt	31.01.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha; z.S.Boqolli; z.R.Mahmutoviq; z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj z.A.Tigani; dhe të ftuar tjerë
	E rregullt	14.03.2018	13,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha; z.S.Boqolli;

2				z.R.Mahmutoviq; z.S.Veseli z.E.Abdullahi;; z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani - KE si dhe të ftuar tjerë
3	E rregullt	30.03.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve: z.B.Basha; z.S.Boqolli;; z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani – KE dhe të ftuar tjerë.
4	E rregullt	27.04.2018	14,00	Bordi I Drejtorëve: z.B.Basha;; z.R.Mahmutoviq; z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani – KE dhe të ftuar tjerë
5	E rregullt	29.05.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha; z.S.Boqolli;; z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj; z.Rasim Mahmutoviq z.A.Tigani – KE dhe të ftuar tjerë
6	MPVA	20.06.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.S.Boqolli; z.R.Mahmutoviq z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani KE ; z.Arianit Ibrahim – Këshilltar i Drejtorit të NjPMNP, znjsh.Filloreta Gashi dhe z. Moris Hyseni – analistë në NjPMNP si dhe të ftuar tjerë.
7	E rregullt	04.07.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha; z.S.Boqolli; z.R.Mahmutoviq; z.E.Abdullahi; z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani - KE dhe të ftuar tjerë
8	E rregullt	31.07.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha; z.S.Boqolli; z.R.Mahmutoviq; z.E.Abdullahi, z.S.Veseli; z.M.Mushkolaj; z.A.Tigani - KE dhe të ftuar tjerë
9	E rregullt	11.09.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve: z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
10	E rregullt	02.10.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve: z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
11	E rregullt	23.10.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve : z. Burim Basha, z. Sokol Boqolli z.Esad.Abdullahi, z.Rasim Mahmutoviq, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj, z.A.Tigani si dhe të ftuar tjerë.
12	E rregullt	03.12.2018	10,00	Bordi i Drejtorëve: z.B.Basha, z.Sokol Boqolli, z.R.Mahmutoviq; z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani dhe të ftuar tjerë
13	E rregullt	27.12.2018	10,00	Bordi i Drejtorëve: z.Burim.Basha, z.Sokol Boqolli, z.Esat Abdullahi, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj, z.Agron Tigani dhe të ftuar tjerë.
14	E jashtëzakonshme	30.10.2018	10,00	Bordi I Drejtorëve : z.B.Basha, z.S.Boqolli, z.R.Mahmutoviq, z.E.Abdullahi, z.S.Veseli, z.M.Mushkolaj, z.A.Tigani – KE dhe të ftuar tjerë

- Në KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë gjatë vitit 2018 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 12 (dymbëdhjetë) mbledhje, të rregullta, 1 (një) të jashtëzakonëshme si dhe Mbledhjen e Përgjithëshme Vjetore e Aksionarit.
- Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2018 ka operuar si një Bord unik dhe vendimet e marrura gjatë kësaj periudhe kanë qenë vendime të marrura me konsensus.

o Komisioni I Auditimit në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë ka këtë përbërje:

1. Sokol Boqolli kryesues..... dt. emërimit 23.11.2015
2. Skënder Veseli..... anëtar..... dt. emërimit 23.11.2015
3. Musë Mushkolaj..... anëtar dt. emërimit 23.11.2015

Mbledhjet e rregullta të Komisionit të Auditimit të mbajtura gjatë vitit 2018:

Nr:	Mbledhjet e Komisionit të Auditimit	Data	Ora	Personat prezent në mbledhje
1	E rregullt	29.01.2018	10,30	Komisioni I Auditimit: z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe znj.Aurora Dinaj – ZAB si dhe të ftuar tjerë
2	E rregullt	28.02.2018	10,30	Komisioni I Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj dhe znj.Aurora Dinaj –ZAB si dhe të ftuar tjerë
3	E rregullt	27.03.2018	10,00	Komisioni I Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj znj.Aurora Dinaj – ZAB si dhe të ftuar tjerë
4	E rregullt	25.04.2018	10,30	Komisioni i Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj, znj.Aurora Dinaj - ZAB si dhe të ftuar tjerë
5	E rregullt	24.05.2018	14,00	Komisioni I Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, znj.Aurora Dinaj – ZAB si dhe të ftuar tjerë
6	E rregullt	28.06.2018	10,30	Komisioni I Auditimit: z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj , znj.Aurora Dinaj - ZAB dhe të ftuar tjerë.

7	E rregullt	26.07.2018	10,30	Komisioni i Auditimit: z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj znj.Aurora Dinaj – ZAB dhe të ftuar tjerë
8	E rregullt	07.09.2018	10,00	Komisioni i Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Musë Mushkolaj, z.Skënder Veseli znj.Aurora Dinaj - ZAB si dhe të ftuar tjerë
9	E rregullt	27.09.2018	10,30	Komisioni i Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj, znj. Aurora Dinaj - ZAB dhe të ftuar tjerë
10	E rregullt	19.10.2018	10,30	Komisioni i Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli , z.Musë Mushkolaj, znj.Aurora Dinaj – ZAB dhe të ftuar tjerë
11	E rregullt	27.11.2018	10,00	Komisioni i Auditimit : z.Sokol Boqolli z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj znj.Aurora Dinaj ZAB dhe të ftuar tjerë
12	E rregullt	24.12.2018	10,00	Komisioni i Auditimit : z.Sokol Boqolli, z.Skënder Veseli, z.Musë Mushkolaj, znj.Aurora Dinaj – ZAB dhe të ftuar tjerë

• **Informacione te tjera**

○ ***Kërkesat për likuidimin e Ndërmarrjeve shoqërore për vitin 2018***

KRU "Hidrodrini" Sh. A.- Pejë, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa të tilla.

○ ***Informacione tjera, ashtu siç parashihet në LNP dhe statutin e NP-ve***

Informata për aksionarin:

- **Informacione lidhur me Asetet e Kompanisë:**

Në vitin 2017 vlera e aseteve neto është 20,157,959€, kurse ne vitin 2018 është 19,559,286€.

Numri I punëtorëve gjatë viteve nuk ka ndryshuar, caku I menaxhmentit është që stafi të trajnohet ashtu që të ritet efikasiteti në punë.

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2015..... **5.00,**

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2016..... **4.73,**

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2017..... **4.50,**

Efikasiteti I stafit gjatë vitit 2018..... **4.10.**

(Es - është raporti i numrit te punëtorëve me konsumatorë, 1/1000)

3. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

• Ngjarjet kryesore të vitit 2018

Janar – Mars 2018 - TM1

- R Raportin Operativ dhe Financiar të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për Dhjetor dhe TM4 – 2017 (Vendimi Nr.prot 03//01/01/2018 dt.31.01.2018)
- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. për Dhjetor dhe TM4 - 2017 (Vendimi Nr.prot 03/02/01/2018 dt.31.01.2018) .
- Raportin mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “ Hidrodrini ” Sh. A. për TM4 – 2017. (Vendimi Nr.prot.3/03/01/2018 dt.31.01.2018).
- Planin për Menaxhimin e Thatësisë në KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë
- (Vendimi Nr.prot.3/04/01/2018 dt.31.01.2018).
- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për muajin Janar-2018 (Vendimi Nr.prot.6/01/02/2018 dt.14.03.2018).
- Pasqyrat Financiare të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë për vitin 2017
- (Vendimi Nr. prot.6/02/02/2018 dt.14.03.2018).
- Raportin Vjetor i Performances të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2017
- (Vendimi Nr. Prot.6/03/02/2018 dt.14.03.2018).
- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për Shkurt-2018
- (Vendimi Nr.prot.9/01/03/2018 dt.30.03.2018).
- Raportin Vjetor mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2017 (Vendimi Nr.prot.9/02/03/2018 dt.30.03.2018).

Dokumentat e aprovuara në mbledhjet e cekura më lartë janë përcjellur nga KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë në NjPMNP, brenda afatit ligjor - Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, Raportet Operative dhe Financiare të cekura më lartë, Raporti Vjetor i Performances të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2017, Raporti mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve për TM4 – 2017 dhe Raporti Vjetor mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve - 2017. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është përgatitur edhe Qeverisja Korporative e KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për vitin 2017 dhe e njëjta është dorëzuar si kopje fizike në NjPMNP, në afat ligjor.

Prill – Qershor 2018 – TM2

- Raportin Operativ dhe Financiar i KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë për Mars dhe TM1 - 2018 (Vendimi nr.prot.12/01/04.2018 dt.27.04.2018).

- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës i KRU “Hidrodrini” Sh. A. për TM1 – 2018 (Vendimi nr.prot.12/02/04/2018 dt.27.04.2018).
- Raportin mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “Hidrodrini” Sh. A. për TM1 – 2018. (Vendimi nr.prot.12/03/04/2018 dt.27.04.2018)
- Raportin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2017 (Vendimi nr.prot.12/04/04/2018 dt.27.04.2018).
- Raportin Operativ dhe Financiar i KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë për Prill - 2018. (Vendimi Nr.prot.15/01/05/2018, dt.29.05.2018).
- Letër Menaxhmentin e Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë, për vitin 2017. (Vendimi Nr.prot. 15/02/05/2018 dt.29.05.2018)
- Aplikacionin e KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për përtrirjen e Licencës për kryerjen e shërbimeve nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit. (Vendimi Nr.prot.15/03/05/2018 dt.29.05.2018).

Kryeshefi Ekzekutiv z.Agron Tigani autorizohet, në emër të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë të aplikoj për licencë të shërbimeve pranë Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujitë .(Nr.prot.723 dt.30.05.2018)

- Ndryshimn dhe Plotësimin e Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare të KRU “ Hidrodrini “ Ndryshohet dhe plotësohet neni 7 (paragrafi 7.1; 7.2; 7.3 dhe 7.4) i Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare (Vendimi Nr.prot. 15/04/ 05/2018 dt. 29.05.2018)
- Raportin Operativ dhe Financiar i KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë për Maj – 2018 (Vendimi nr.prot.20/01/06/2018 dt.04.07.2018).Duke u bazuar në dispozitat ligjore Bordi i Drejtorëve ka bërë edhe: Vetvlerësimin e Bordit të Drejtorëve, sipas të cilit është konstatuar që Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2017 ka operuar si një Bord unik dhe se vendimet e marrura gjatë kësaj periudhe kanë qenë vendime të marrura me konsensus, me vota unanime. (Nr.prot.720 dt.30.05.2018)
- Vlerësimin e performances së menaxhmentit për vitin 2017.(Nr.prot.721 dt.30.05.2018).

Në Mbledhjen e Përgjithëshme Vjetore të Aksionarit (MPVA) të dt.20.06.2018 janë aprovuar këto dokumenta :

- Raportin e Auditorit të Jashtëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për vitin 2017 dhe Letër Menaxhmentin me Nr.prot 718 dt.30.05.2018 (Vendimi nr.prot.17/01/2018 dt.20.06.2018)
- Raportin Vjetor i KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për vitin 2017 me Nr.prot.347, dt.14.03.2018 (Vendimi nr.prot.17/02/2018 dt.20.06.2018)
- Konstatimin e Bordit të Drejtorëve Nr.prot. 721 të dt.30.05.2018 lidhur me Performancën e Menaxhmentit të Kompanisë. (Vendimi nr.prot.17/03/2018 dt.20.06.2018)

Dokumentat e aprovuara në mbledhjet e cekura më lartë janë përcjellur nga KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, në NjPMNP brenda afatit ligjor (Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, Raportet Operative dhe Financiare, Raporti I Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për vitin 2017 dhe Letër Menaxhmenti, Vetvlerësimi i Bordit të Drejtorëve 2017 dhe Vlerësimi i performances së Menaxhmentit për vitin 2017).

Korrik – Shtator 2018 – TM3

- Raportin Operativ dhe Financiar i KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë për Qershor dhe TM2 - 2018 (Vendimi . Nr.prot. 23/01/07/2018 të dt.31.07.2018)
- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës i KRU “Hidrodrini“ Sh. A. për TM2 – 2018 (Vendimi Nr.prot.23/02/07/2018 dt.31.07.2018).
- Raportin mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “Hidrodrini” Sh. A. për TM2 – 2018. (Vendimi nr.prot.23/03/07/2018 dt.31.07.2018)
- Rishikimin e Planit të Biznesit 2018 të harmonizuar me Planin e tarifave - 2018 të ARRUS si vijon :
- Uji i prodhuar është zvogëluar për 4.8% nga 25,659,957 m³....në 24,000,000 m³
 Uji i faturuar është zvogëluar për 2.9%nga 9,900,000 m³në 9,615,000 m³
 Faturimi është zvogëluar për 7.1 %nga 4,080,000 €.....në 3,790,788 €
 Inkasimi është rritur për 4.5%..... nga 3,120,000 €në 3,261,276 €
 Shpenzimet operative pa amortizim janë zvogëluar për 7.3% ..nga 2,760,000 €.në 2,559,024 €
 Uji i faturuar për konsumator me ujëmatësa është zvogëluar për 1.5% .nga 9,426,000 m³ në 9,289,200 m³

Me propozimin e menaxhmentit, Bordi i Drejtorëve do të merr vendim për ridestitim të mjeteve për projektin e furnizimit me tre (3) eskavatorë. në vlerë prej 340,000.00 €

- Deklaratën për Politikën e Kompensimit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të Lartë të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. Pejë.
- Kërkesën e Menaxhmentit të Kompanisë që me rastin e Festës së Kurban Bajramit të gjithë punëtorëve të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë të ju ndahen mjete financiare në vlerë bruto prej 50 € për secilin punëtor.
- Raportin Operativ dhe Financiar i KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë për Korrik - 2018. Vendimi Nr.prot. 26/01/08/2018 dt.11.09.2018
- Që mjetet financiare të kalkuluara nga paga e inkasantëve për muajin Gusht - 2018 të ju kompenzohen në xhirrollogarinë e secilit që I është bërë kalkulimi.
- Obligohet menaxhmenti që të hartoj një Rregullore për procedurat e inkasimit dhe leximit të ujëmatësave, respektivisht për kriteret e pagesës (stimulimin dhe destimulimin) të inkasantëve duke filluar nga dt.01.09.2018.(Vendimi Nr.prot.23/02/08/2018 dt.11.09.2018)

- Kërkesën Nr.prot.1259 dt.10.09.2018 të parashtruar nga menaxheri i NjO të Pejës, për ndyshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.2/2017 për procedurat e lidhjes së Konsumatorëve në shërbimet e ujit, (Vendimi Nr.prot.26/03/08/2018 dt.11.09.2018)
- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU “Hidrodrini” Sh.A.Pejë për muajin Gusht – 2018 (Vendimi Nr.prot.29/01/09/2018 dt.02.10.2018)
- Rregulloren për llogaritjen e pagave të inkasantëve të KRU “ Hidrodrini” Sh.A. Pejë. (Vendimi Nr.prot.29/02/09/2018 të dt.02.10.2018).

Dokumentat e aprovuara në mbledhjet e cekura më lartë janë përcjellur nga KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, në NjPMNP brenda afatit ligjor (Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, Raportet Operative dhe Financiare mujore dhe TM, Rishikimi i Planit të Biznesit 2018, Raporti i Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për TM3.

Tetor– Dhjetor 2018 – TM4

- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë për Shtator dhe TM3 - 2018 (Vendimi Nr.prot. 32/01/10/2018 dt.23.10.2018)
- Raportin mbi realizimin e Planit të Biznesit sipas dinamikës të KRU “Hidrodrini“ Sh. A. për TM3 - 2018 (Vendimi Nr.prot 32/02/10/2018 dt.23.10.2018) .
- Raportin mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve të KRU “Hidrodrini” Sh. A. për TM3 – 2018 (Vendimi Nr.prot.32/03/10/2018 dt.23.10.2018) .
- Pas implementimit të sugjerimeve për plotësim dhe propozimeve të dhëna për korigjime të gabimeve teknike Draft Plani I Biznesit dhe Buxheti Vjetor I KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë për periudhën 2019 – 2021 do të shqyrtohet në një mbledhje të jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve brenda afatit ligjor për aprovim. (Vendimi Nr.prot.32/04/10/2018 dt. 23.10.2018)

- I.Nga dt.01.01.2018 KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë do të faturtoj konsumatorët e 10 (dhjetë) fshatrave të Deçanit si vijon:

- | | |
|--------------|----------------|
| 1. Prilep | 6. Shaptej |
| 2. Prokolluk | 7. Dubravë |
| 3. Irzniq | 8. Gramaqel |
| 4. Kodrali | 9. Baballoq |
| 5. Gllogjan | 10. Jasiq i Ri |

II. Nga dt.01.01.2017 të faturohen konsumatorët e fshatit Brestovik.

III. Konsumatorët e fshatit Raushiq të faturohen nga dt.01.07.2018.

IV. Konsumatorët e fshatit Vrellë të faturohen nga data 01.07.2017.

Faturimi I konsumatorëve para këtyre datave të cekura më lartë është I pavlefshëm. (Vendimi Nr. Prot.32/05/10/2018 dt.23.10.2018)

- Planin e Biznesit dhe Buxhetin Vjetor të KRU “Hidrodrini “Sh. A. Pejë për periudhën 2019-2021 (Vendimi Nr.prot.34/01/2018 dt.30.10.2018).
- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU “Hidrodrini”Sh.A. Pejë për Tetor – 2018 (Vendimi Nr.prot.32/01/11/2018 dt.03.12.2018)

- Raportin Operativ dhe Financiar të KRU "Hidrodrini" Sh.A. Pejë për Nëntor - 2018 (Vendimi Nr.prot.40/01/12/2018 dt.27.12.2018).
- Kërkesën Nr.prot.1063 të dt.26.12.2018 e parashtruar nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë që me rastin e Festës së Vitit të Ri të gjithë punëtorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë të ju ndahen mjete financiare në vlerë bruto prej 100 € për secilin punëtor, të cilat mjete do të shpërndahen bashkë me pagën e muajit Dhjetor – 2018 (Vendimi Nr.prot.40/02/12/2018 dt.27.12.2018).

Dokumentat e aprovuara në mbledhjet e cekura më lartë janë përcjellur nga KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, në NjPMNP brenda afatit ligjor (Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit, Raportet Operative dhe Financiare të cekura, Raporti mbi Kënaqshmërinë e Konsumatorëve TM3 – 2018).

• Pasqyrën e performances operative dhe financiare si dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances

o ***Prodhimi i ujit***

KRU"Hidrodrini"Sh.A. - 2018			
Totali			
	Prodhimi mes. ditor	Prodhimi mujor	Prodhimi mesatar
	m ³	m ³	l/s
Janar	68,135	2,112,186	789
Shkurt	68,615	2,127,051	794
Mars	68,678	2,129,033	795
Prill	67,764	2,100,669	784
Maj	67,891	2,104,633	786
Qershor	68,103	2,111,195	788
Korrik	68,334	2,118,360	791
Gusht	68,554	2,125,176	793
Shtator	68,585	2,126,141	794
Tetor	68,613	2,126,998	794
Nëntor	67,522	2,093,170	782
Dhjetor	67,474	2,091,696	781
MES.	68,189	2,113,859	789

○ **Kualiteti i ujit**

Kualiteti i Ujitë - KRU"Hydrodrini"	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Totali i Testeve të realizuara	258	2,597	2,385	2.532
- Që nuk janë në pajtim me standardet	4	0.16	0	0
- % (keq)	1.5%	0%	0%	0%

○ **Ankesat te zgjedhura**

Treguesi	Aktiviteti	Totali
Ankesat Teknike te pranuar	Nr. Total	5.229
	Të shqyrtuara dhe të zgjedhura me kohë	5,229
Ankesat komerciale te pranuar	Nr. Total	179
	Të shqyrtuara dhe të zgjedhura me kohë	179

○ **Çështjet Ligjore**

Gjatë vitit 2018 është mbajtur një Seancë Gjyqësore në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë. V.E.K.nr.47/17. Paditës Komuna e Pejës lidhur me rastin e ndërtimit të Shkollës së Muzikës "Halil Kasapoll" në Pejë, ku me rastin e shpërthimit të gypit të ujit është dëmtuar pjesa fillestare e punimëve të objektit të shkollës.

E paditur Kompania Hidrodrini. Baza e Kontestit Kompanzim dëmi. Vlera e kontestit 54285.50 euro. Pas mbajtjes së Seancës Gjyqësore është mar vendim që të caktohet marrja e provës me ekspertize teknike me qëllim të vertetimit të faktit se me fajin e kujt është dhe se si është ardh deri të shpërthimi i gypit të ujit. Për seancën e radhës njoftohen palët me ftesë.

PROCEDURAT ME PËRMBARUES PRIVAT - VITI: 2018

Propozime për Përmbarrim		Pagesa të realizuara nga Përmbarruesi Privat		Pagesat të cilat Hidrodrini i ka paguar Përmbarruesit Privat	
Zani Shpk	119 Propozime	Zani Shpk	65,086.31 euro	Zani Shpk	11,471.3 euro
BK Partners	51 Propozime	BK Partners	10,341.87 euro	BK Partners	4,811.99 euro
Nato Law	70 Propozime	Nato Law	2,634 euro	Nato Law	6,470 euro
Total:	240 Propozime	Total:	78,062.18 euro	Total:	22,753.29 euro

Shuma totale e për tu paditur për vitin 2018:

TM1	TM2	TM3	TM4
83,371.41 euro	47,682.59 euro	52,911.98 euro	76,822.03 euro
Total: 260,788.01 euro			

- **Pasqyra e performances financiare dhe rezultatet**

Nga Pasqyrat Financiare për vitet kemi:

Gjatë vitit 2015, fitimi prej 2,238 €.

Gjatë vitit 2016, fitimi prej 3,170 €.

Gjatë vitit 2017, fitim prej 26,964 €.

Gjatë vitit 2018, fitimi prej 35,204 €.

- **Progresi me planin e Biznesit**

Në tabelarin e mëposhtëm, është bërë krahasimi i vlerave të arritura gjatë viteve si dhe atyre të planifikuara për vitin 2018, që janë indikatorët kyç të performances.

Raporti Operativ dhe Financiar – Performanca 2018.

Company Name/Emri i Kompanise: HIDRODRINI, PEJE									Half Year Results for 6-months
Year/Viti : 2018									
Month/Muaji: 12									
Closing Results from Previous Year									Half Year Results for 6-months
Report on Key Performance Data and Indicators - January to June	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun			
Rezultatet Permblyese te Vitet te Kaluar									Half Year Results for 6-months
Raporti mbi Te Dhenat dhe Treguesit Kryesor te Performances - Janar deri Qershor	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer			
	1	2	3	4	5	6			
D 001 Water Production (m3) / Uji i Prodhuar	25,659,957	2,112,186	2,127,051	2,129,033	2,100,669	2,104,633	2,111,195	12,684,767	
D 002 Water invoiced (m3) / Uji i faturuar	9,266,841	785,684	661,290	764,951	755,612	827,871	801,322	4,596,730	
D 0021 Uji I pa faturuar I kontrolluar(m3)	433,850	26,542	22,799	34,619	24,260	25,952	23,086	157,258	
D 003 Registered customers / Konsumatorët e regjistruar	48,260	49,001	49,128	49,201	49,295	49,464	49,586	49,586	
D 004 Number of bills issued / Nr. i faturave të lëshuara	45,495	45,761	45,786	45,831	45,877	46,040	46,196	46,196	
D 005 Customers billed by meter / Numri i kons. qe faturohen sipas leximit te ujematesave	43,410	44,443	44,566	44,614	44,660	44,820	44,991	44,991	
D 006 Water metered invoiced (m3) / Uji i faturuar per konsumatorët me ujematesa	9,076,294	742,848	597,638	689,746	690,737	761,249	738,043	4,220,261	
D 007 Value of bills (Eur) / Faturimi	€ 3,644,856	€ 306,864	€ 266,603	€ 294,961	€ 294,261	€ 319,375	€ 312,944	1,795,009	
D 008 Value of collections (Eur) / Inkasimi	€ 2,912,768	€ 248,846	€ 205,600	€ 248,706	€ 255,635	€ 228,669	€ 200,685	1,388,142	
D 009 Other operating income (Eur) / Të hyra të tjera operative	€ 49,467	€ 963	€ 1,529	€ 1,352	€ 2,250	€ 3,586	€ 1,425	11,104	
D 010 Operating costs (Eur) / Shpenzimet operative pa amortizim	€ 2,448,281	€ 196,895	€ 187,365	€ 201,701	€ 202,513	€ 197,853	€ 189,308	1,175,634	
D 011 Non operating income (Eur) / Të hyrat jo operative	€ 90,066	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	0	
D 012 Non operating costs (Eur) / Shpenzimet jo operative	€ 564,399	€ 11,371	€ 17,389	€ 4,572	€ 91,054	€ 16,426	€ 97,355	238,167	
D 013 Write offs towards debtors (Eur) / Shlyerja e borxheve ndaj borxhlinjeve(konsumatoreve)	€ 20,807	€ 1,234	€ 6,104	€ 1,679	€ 459	€ 1,509	€ 843	11,829	
D 014 Write offs towards creditors (Eur) / Shlyerja e obligimeve nga kreditorët (furnitorët)	€ 94,441	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	€ -	0	
D 015 Cash on hand and bank (Eur) / Paratë e gatshme në arke dhe në bankë	€ 916,565	€ 1,131,336	€ 1,115,900	€ 1,167,078	€ 1,222,183	€ 1,222,554	€ 1,255,336	€ 1,255,336	
D 016 Stock (Eur) / Stoqet	€ 475,965	€ 541,626	€ 535,334	€ 527,746	€ 532,118	€ 518,006	€ 515,744	€ 515,744	
D 017 Accounts receivable based on billing (Eur) / Logaritë e arketueshme (nga faturat)	€ 17,544,093	€ 17,607,634	€ 17,667,107	€ 17,700,980	€ 17,741,094	€ 17,829,552	€ 17,915,697	€ 17,915,697	
D 018 Other accounts receivable (Eur) / Logaritë tjera te arketueshme	€ 80,425	€ 81,201	€ 81,896	€ 82,639	€ 82,410	€ 83,044	€ 83,424	€ 83,424	
